

VENDIM
Nr.605, datë 8.7.2010

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.1093, DATË 2.7.2008 “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË SISTEMIT TATIMOR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, dhe të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.1093, datë 2.7.2008, të ndryshuar bëhen këto ndryshime:
 - a) Lidhja nr.1, e përmendur në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër “Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e tatimeve”, bashkëlidhur këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 - b) Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Paga e grupit (kolona 2) e lidhjes nr.1, është sipas lidhjes nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.
 2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, do të përballohen nga fondet e parashikuara për rritjen e pagave për vitin 2010.
 3. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrinë efektet nga data 1 korrik 2010.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E SISTEMIT TË TATIMEVE

				PAGA MUJORE			
			EMËRTIMI	PAGA INDIVIDUALE		SHTESA E POZICIONIT	
Kategoria E vendit të punës	Kategoria e pagës	Paga e grupit (PG)		Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)	Shtesa për kushte pune
1	2	3	4	5	6	7	8
	II-a	1	Drejtor i Përgjithshëm	2%		105 000	20 000
	II-b	1	Zv/drejtor i përgjithshëm	2%		88 000	15 000
	III-a	1	Drejtor drejtorie në drejtorinë e përgjithshme. Drejtor i drejtorisë rajonale.	2%		71 000	15 000
B	III-a/1	1	Përgjegjës/shef sektori në drejtorinë e përgjithshme. Drejtor drejtorie në drejtorinë rajonale.	2%		62 000	14 000
C.1	III-b	1 ose 2	Përgjegjës/shef sektori/zyre në drejtorinë rajonale. Inspektor i parë. Inspektor i auditit të brendshëm. Përgjegjës sektori në drejtorinë mbështetëse në drejtorinë e përgjithshme. Inspektor hetimi në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.	2%		54 000	12 000

	III-b	1 ose 2	Përgjegjës zyre në Task-Forcë	2%		54 000	17 000
C.2	IV-a	1 ose 2 ose 3	Inspektor i dytë.Specialist në Drejtorinë e Përgjithshme. Inspektor hetimi në Drejtorinë e Përgjithshme dhe në drejtoritë rajonale.	2%		43 000	12 000
	IV-b	1 ose 2 ose 3	Specialist në Drejtorinë e Përgjithshme,.Inspektor hetimi/Specialist në drejtoritë rajonale.	2%		33 000	10 000
C.3	IV-c	1 ose 2 ose 3	Specialist	2%		25 000	5000
D.1	IV-b	1 ose 2 ose 3	Sekretar në drejtorinë e përgjithshme	2%		33 000	5000
	IV-c	1 ose 2 ose 3	Sekretar në drejtoritë rajonale.	2%		25 000	5000
			Nëninspektor	1%		28 000	10 000

Lidhja nr.3

VLERA E PAGËS SË GRUPIT PËR GRUPET E DIPLOMAVE TË ARSIMIT UNIVERSITAR

Grupi i diplomës	Lloji i diplomës	Vlera
1	Diplomë e Nivelit të Dytë (DND) Diplomë e Integruar e Nivelit të Dytë (DIND). Të barasvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	12 000 lekë
2	Diplomë e Nivelit të Parë (DNP) apo të barasvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë + master i nivelit të parë (MNP)	11 000 lekë
3	Diplomë e Nivelit të Parë (DNP) Të barasvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	10 000 lekë